

**20170961907**

**BANKA POPULLORE E REPUBLIKËS SË MAQEDONISË**

Në bazë të nenit 25 dhe 47 paragrafi 1 pika 20 nga Ligji për Bankën Popullore të Republikës së Maqedonisë ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 158/10, 123/12, 43/14, 153/15 dhe 6/16), Këshilli i Bankës Popullore të Republikës së Maqedonisë miratoi

**VENDIM PËR LËSHIM NË QARKULLIM TË MONEDHAVE ME VLERË NOMINALE**  
**10 DENARË**

1. Me këtë vendim lëshohen në qarkullim monedhat me vlerë nominale 10 denarë me shenjë të emetimit "2017" dhe me karakteristikat e parapara në Vendimin për karakteristikat themelore të monedhave me vlerë nominale 10 dhe 50 denarë ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 54/07), duke filluar nga data 1 gusht i vitit 2017.

2. Me lëshimin në qarkullim të monedhave nga pika 1 e këtij vendimi, paralelisht në qarkullim në operacionet me para të gatshme në Republikën e Maqedonisë do të jenë edhe monedhat me vlerë nominale 10 denarë, të emetuara në bazë të Vendimit për karakteristikat themelore të monedhave me vlerë nominale 10 dhe 50 denarë ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 54/07) dhe të lëshuara në qarkullim në bazë të Vendimit për lëshim në qarkullim të monedhave me vlerë nominale 10 dhe 50 denarë ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 139/08).

3. Ky vendim hyn në fuqi nga dita e shpalljes në "Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë".

Nr.V. 02-15/VII-4/2017  
27 korrik viti 2017  
Shkup

Guvernator dhe Kryetar  
i Këshillit të Bankës Popullore  
të Republikës së Maqedonisë  
Dimitar Bogov